



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-CC-PR-2017-01

Vendosi: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**
Gjykatëse An Pauër-Ford, kryetare
Gjykatës Vidar Stensland
Gjykatës Roland Dekers
Gjykatës Antonio Balsamo, gjykatës rezervë

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 12 prill 2017

Gjuha origjinale: Anglishte

Titulli: Referimi i Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas
nenit 19(5) të Ligjit

PUBLIK

VENDIM

**Për gjuhën e punës në lidhje me Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të
Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit**

PANELI I GJYKATËS KUSHTETUESE, i caktuar në bazë të nenit 33(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('Ligji') dhe duke vepruar në bazë të nenit 20 të Ligjit, vendos në lidhje me gjuhën e punës në procedurën e këtij paneli.

1. Më 27 mars 2017, në bazë të nenit 19(5) të Ligjit, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese iu referua Rregullorja e Procedurës dhe e Provave miratuar nga gjykatësit e Dhomave të Specializuara të mbledhur në seancë plenare, me përjashtim të gjykatësve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.
2. Neni 20 i Ligjit parashtrohet se 'gjatë çdo procedure, ... paneli mund të vendosë për gjuhën e punës gjatë procedurës'.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, dhe në përputhje me nenin 20 të Ligjit,

PANELI I GJYKATËS KUSHTETUESE NË VIJIM

vendos që gjuha e punës për procedurën në lidhje me Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit, të jetë **anglishtja**.

(nënshkrim)

Gjykatëse An Pauër-Ford

Kryetare

Hartuar në anglishte, e mërkurë, 12 prill 2017,
Në Hagë, Holandë.